



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## Njoftim Publik

Në drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni **05nr.350/02–195088/25 dt.31.12.2025**, në emër të Pronarve: Sami Pacolli, Nazmi Pacolli, Shaban Pacolli, Ajmona Tafa, Izet Maxhuni, Ali Hajdini, Sala Hajdini, Ramadan Makolli, Rrahman Pacolli, Agron Pacolli, Muhamet Gërbeshi, Emin Tahiri, Muhamet Sylejmani, Valmir Makolli, Ibrahim Haziri, Ismail Makolli dhe Izet Makolli nga Prishtina dhe Investitori N.P. “Besa-Komerce” me seli në Lipjan, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet 3B+3S+P+9 në kuadër të bllokut urban “A5”, Plani Rregullues “Prishtina e Re - Zona Qendër” në Prishtinë-PZHU-së, konkretisht parcelave: nr.1490-15, 929-3, 940-13, 940-29, 940-30, 940-31, 940-32, 940-33, 940-36, 940-40, 940-34, 940-38, 940-39, 940-35 dhe 940-62 ZK Matičan, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit - “zgjidhjes urbane” të prezantuar.Me aplikacion është prezantuar edhe projekt propozimi për ndërtimin e kompleksit të lartcekur. Bazuar në pikën 2 të nënit 18 të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110 dt. 31.05.2012,“Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit”. Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **24.04.2026** deri me datën **05.05.2026** në Email adresën: **urbanizmprihtine@rks-gov.net**.

Kushtet e propozuara: <b>Ndërtesa shumë banesore &amp; afariste</b>	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	“Arë e Klasës 7”, “Arë e Klasës 4”
b. Vija rregulluese	8.00m’ Sipas Planit rregullues Prishtina e Re - Zona Qendër”
c. Vija ndërtimore	8.00m’ Sipas Planit rregullues Prishtina e Re - Zona Qendër”
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	7.00m’ / 7.00m’
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	Anësor: 7.00m’/7.00m’ & 7.00m’/7.00m’ Pasmë : 7.0m’/50m’
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	Koeficienti 3.0 Sipas Planit rregullues Prishtina e Re - Zona Qendër”
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	40% Sipas Planit rregullues Prishtina e Re - Zona Qendër”
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40% Sipas Planit rregullues Prishtina e Re - Zona Qendër”
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60% Sipas Planit rregullues Prishtina e Re - Zona Qendër”
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	<b>70 VP</b>
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përkthuhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.  
Nënshkrimi i Zyrtarit: \_\_\_\_\_

Faqe 1 prej 1

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit  
Adresa: rr. “Radovan Zogoviq” nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: [urbanizmprihtine@rks-gov.net](mailto:urbanizmprihtine@rks-gov.net)